





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
M.B.No.	01 / 532	
DATA/DT.	06. 06. 2024	
	PRISHTINË - A	

**UDHËZUES PËR NORMËN E PUNËS SË
BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL**

Prishtinë, 30.05.2024

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.17 dhe 1.24 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 39, paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, si dhe kapitullit 3 të Rregullores 15/2022 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin, Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës së Bashkëpunëtorit Profesional në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024,

Miraton:

UDHËZUES PËR NORMËN E PUNËS SË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL

Neni 1 Qëllimi i Udhëzuesit

Qëllimi i këtij udhëzuesi është përcaktimi i kriterëve për normën e punës së bashkëpunëtorëve profesional, të cilët punojnë në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi i Udhëzuesit

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional, përcaktohet sipas këtij udhëzuesi, si dhe ndërlidhet me normën e punës së gjyqtarit me të cilin punon, varësisht nga fusha dhe specifika e departamentit.

Neni 3 Vlerësimi i normës së punës së bashkëpunëtorit profesional

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional vlerësohet duke u bazuar në sistemin e vlerësimit me pikë për secilën lëmi përfshirë edhe llojin dhe natyrën e lëndëve, varësisht nga fusha ku bashkëpunëtori është i caktuar të punoj.

Neni 4 Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Supreme

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Supreme të Kosovës, përcaktohet nga Kryetari i Gjykatës Supreme, pas konsultimit me kolegjet e gjyqtarëve brenda kësaj gjykate.

Neni 5

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme në Shkallë të Dytë

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Shkallë të Dytë, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuar si në vijim:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të Dhomës së Posaçme në shkallë të dytë, vlerësohen me dy pikë shtatëdhjetë e pesë (2.75) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve për lëndët lidhur me padinë e listave të punëtorëve për secilin ankues, si dhe lëndët lidhur me paditë e listave të punëtorëve për paga, kontributet, lëndimet dhe borxhet, vlerësohen me zero pikë shtatëdhjetë e pesë (0.75) pikë, por një lëndë pavarësisht numrit të ankuesve nuk mund të tejkaloj pesë (5) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve procedurale, përfshirë edhe masat e sigurimit, vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve të cilat përfshijnë kontestet pronësore - vërtetimi i pronësisë, të drejtat banesore, paditë për të drejtat banesore, servitutet, parablerja, barra sendore, e drejta e ndërtimit, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit, kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor dhe kontestet me kundërpadi me shqyrtim kryesor, vlerësohen me katër (4) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës, analizimi, referimi i lëndës dhe pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, vlerësohet me një pikë (1) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 6

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme në Shkallë të Parë

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Shkallë të Parë, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuar si në vijim:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të Dhomës së Posaçme në shkallë të parë, vlerësohen me dy pikë shtatëdhjetë e pesë (2.75) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve për lëndët lidhur me paditë e listave të punëtorëve për secilin ankues, si dhe lëndët lidhur me paditë e listave të punëtorëve për paga, kontributet, lëndimet dhe borxhet, vlerësohen me zero pikë shtatëdhjetë e pesë (0.75) pikë, por një lëndë pavarësisht numrit të ankuesve nuk mund të tejkaloj shtatë pikë pesë (7.5) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve procedurale të cilat përfundojnë me vendim procedural, përfshirë edhe masat e sigurimit, vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve të cilat përfshijnë kontestet pronësore - vërtetimi i pronësisë,

paditë për të drejtat banesore, servitutet, parablerja, barra sendore, e drejta e ndërtimit, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit, kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor dhe kontestet me kundërpadi me shqyrtim kryesor, vlerësohen me katër (4) pikë;

- 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të padisë dhe pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 7

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti Special

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit – Departamenti Special, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuar si në vijim:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti, vlerësohen me dymbëdhjetë pikë pesë (12.5) pikë, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve me pranim të fajësisë dhe marrëveshje për pranim fajësie, vlerësohen me shtatë pikë pesë (7.5) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktvendimeve për hedhje të aktakuzës, kundërshtimit të provave, vendimeve procedurale, si dhe lëndët e procedurës paraprake që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve përkatësisht nxjerrjen e aktvendimeve, vlerësohen me dy (2) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve në të cilat numri i të akuzuarve është mbi pesë (5) persona ose nëse çështja penale ka përfunduar me hapjen e shqyrtimit gjyqësor, vlerësohen me shtatëmbëdhjetë pikë pesë (17.5) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës, pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një pikë (1);
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 8

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti për Krime të Rënda

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit – Departamenti për Krime të Rënda, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si në vijim:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti,

- vlerësohen me shtatë pikë pesë (7.5) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve me pranim të fajësisë dhe marrëveshje për pranim të fajësisë, vlerësohen me pesë (5) pikë;
 - 1.3. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktvendimeve për hedhje të aktakuzës, kundërshtimit të provave, vendimeve procedurale, si dhe lëndët e procedurës paraprake që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve përkatësisht nxjerrjen e aktvendimeve, vlerësohen me zero pikë shtatëdhjetë e pesë (0.75) pikë;
 - 1.4. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve ku përfshijnë vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, kontrabandimi me migrant, dhunim, vrasje, vrasje e rëndë, trafikimi me njerëz, krimi i organizuar, terrorizmi, grabitja dhe vjedhja grabitqare, si dhe të gjitha lëndët në të cilat, numri i të akuzuarve është mbi pesë (5) persona ose nëse çështja penale ka përfunduar me hapjen e shqyrtimit gjyqësor vlerësohen me dhjetë (10) pikë;
 - 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës, pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një (1) pikë;
 - 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
 - 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 9

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti për të Mitur

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit – Departamenti për të Mitur, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si vijon:
 - 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti, vlerësohen me pesë (5) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
 - 1.2. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve me pranim të fajësisë dhe marrëveshje për pranim të fajësisë, vlerësohen me dy pikë pesë (2.5) pikë;
 - 1.3. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktvendimeve për hedhje të aktakuzës përkatësisht të propozimit, vendimeve procedurale dhe lëndët e procedurës paraprake, përkatësisht përgatitore që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve, përkatësisht nxjerrjen e aktvendimeve, vlerësohen me zero pikë shtatëdhjetë e pesë (0.75) pikë;
 - 1.4. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve ku përfshijnë vepra penale gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare, vrasje, vrasje e rëndë, trafikimi me njerëz, grabitja dhe vjedhja grabitqare, si dhe të gjitha lëndët në të cilat, numri i të akuzuarve, përkatësisht të miturve është mbi pesë (5) persona ose nëse çështja penale ka përfunduar me hapjen e shqyrtimit gjyqësor, vlerësohen me dhjetë (10) pikë;
 - 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës, pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një (1) pikë;
 - 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve,

- vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 10

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti për Çështje Administrative

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit – Departamenti për Çështje Administrative, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti, vlerësohen me dy pikë njëzetë e pesë (2.25) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve përfshirë, kthimi në rishqyrtim dhe rivendosje, si dhe lëndët për shtyrje të ekzekutimit, vlerësohen me zero pikë shtatëdhjetë e pesë (0.75) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve procedurale përfshirë dhe masat e sigurimit të kërkesave, vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve përfshirë anulim të kontratave administrative si dhe kompensim të dëmeve të kërkuara në kontrata, si dhe lëndët për leje të ndërtimit të cilat përfundojnë me hapje të shqyrtimit kryesor, vlerësohen me tre pikë pesë (3.5) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një (1) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 11

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij divizioni, vlerësohen me nga dy pikë pesë (2.5) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve me pranim të fajësisë dhe marrëveshje për pranim të fajësisë, vlerësohen me një pikë pesë (1.5) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktvendimeve për hedhje të aktakuzës, kundërshtimit të provave, vendimeve procedurale, si dhe lëndët e procedurës paraprake që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve përkatësisht nxjerrjen e

- aktvendimeve, vlerësohen me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve sipas ankesave ndaj aktgjykimeve ku përfshijnë vepra penale lëndime të rënda trupore, vjedhje e rëndë, mashtrim, si dhe te gjitha lëndët në të cilat numri i të akuzuarve është mbi pesë (5) persona ose nëse çështja penale ka përfunduar me hapjen e shqyrtimit gjyqësor, vlerësohen me katër (4) pikë;
 - 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës, pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një (1) pikë;
 - 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
 - 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 12

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij divizioni, vlerësohen me dy pikë pesë (2.5) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve përmbartimore, procedurale përfshirë dhe masat e sigurimit të kërkesave, pagat jubilarë, të përcjelljes në pension, shujtat dhe çështjet tjera të kësaj kategorie vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve nga procedura jo kontestimore vlerësohen me dy (2) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve në kontestet pronësore - vërtetimi i pronësisë, servitutet, parablerja, barra sendore, e drejta e ndërtimit, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, kontestet për fyerje dhe shpifje, kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor dhe kontestet me kundërpadi me shqyrtim kryesor, vlerësohen me katër (4) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të ankesës, pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një pikë (1);
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 13

Norma e punës së bashkëpunëtorit në Gjykatën e Apelit – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtje

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës së Apelit – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjeve, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti, vlerësohen me një pikë njëzetë e pesë (1.25) pikë;
- 1.2. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.3. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 14

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si në vijim:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të Dhomës së shkallës së dytë vlerësohen me dy pikë pesë (2.5) pikë përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve të lëndët e kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, vlerësohen me një pikë njëzet e pesë (1.25) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve procedurale, përfshirë marrëveshjet e ndërmjetësimit, masat e sigurisë, lëndët për shtyrje të ekzekutimit dhe lëndët përmbartimore vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve në kontestet pronësore vërtetimi i pronësisë, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit, kontestet nga e drejta reale, servitutet, barra sendore, pronësia industriale, kërkesa për revokimin e lejeve dhe licencave të agjencive shtetërore, kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor apo personit të interesuar dhe kontestet me kundërpadi me shqyrtim kryesor, kontestet për pronësinë e aksioneve, tërheqjen ose përjashtimin e aksionarit nga shoqëria, kontestet për shndërrimin e investimeve në shoqëri në aksione shtesë, kontratat për projektet investive duke përjashtuar ndërtimin individual, kontratat për transaksionet ndërkombëtare, kontestet ndërmjet kompanive të aviacionit, lëndët për vlerësimin e ligjshmërisë dhe konstatimin e konkurrencës, keqpërdorimit ose monopolit dhe pozitës dominuese në treg, marrëveshjet monopole, shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të përgjithshme administrative të cilat vlerësohen me katër (4) pikë, përjashtim bëjnë kontestet e riorganizimit, falimentimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare vlerësohen me shtatë pikë pesë (7.5) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarrja në shqyrtimin paraprak të ankesës, pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit, analizimi dhe referimi i lëndës vlerësohet me një pikë (1);
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin

- për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 15

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuara si në vijim:
- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të dhomës së shkallës së parë, vlerësohen me dy pikë shtatëdhjetë e pesë (2.75) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
 - 1.2. draftimi i vendimeve procedurale përfshirë marrëveshjet e ndërmjetësimit, masat e sigurisë, lëndët për shtyrje të ekzekutimit dhe lëndët përmbartimore vlerësohen me nga një pikë (1) pikë;
 - 1.3. draftimi i vendimeve të kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, vlerësohen me një pikë njëzetë e pesë (1.25) pikë, përjashtim bëjnë lëndët në Departamentin Fiskal dhe Departamentin për Çështje Administrative, në të cilat gjykata ka nxjerrë ekspertizë dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim, të cilat vlerësohen me një pikë shtatëdhjetë e pesë (1.75) pikë;
 - 1.4. draftimi i vendimeve në kontestet pronësore vërtetimi i pronësisë, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit, kontestet nga e drejta reale servitutet, barra sendore, pronësia industriale, kërkesa për revokimin e lejeve dhe licencave të agjencive shtetërore, kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor apo personit të interesuar dhe kontestet me kundërpadi me shqyrtim kryesor, kontestet për pronësinë e aksioneve, tërheqjen ose përjashtimin e aksionarit nga shoqëria, kontestet për shndërrimin e investimeve në shoqëri në aksione shtesë, kontratat për projektet investive duke përjashtuar ndërtimin individual, kontratat për transaksionet ndërkombëtare, kontestet ndërmjet kompanive të aviacionit, lëndët për vlerësimin e ligjshmërisë dhe konstatimin e konkurrencës, keqpërdorimit ose monopolit dhe pozitës dominuese në treg, marrëveshjet monopole, shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të përgjithshme administrative të cilat vlerësohen me gjashtë (6) pikë, përjashtimisht kontestet e riorganizimit, falimentimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare, vlerësohen me pesëmbëdhjetë (15) pikë;
 - 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të padisë, analizimi i lëndës dhe pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
 - 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
 - 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 16

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti Special

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore – Departamenti Special, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve, dhe pikëve të përcaktuar si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti, vlerësohen me njëzetë (20) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve me pranim të fajësisë dhe marrëveshje për pranim të fajësisë vlerësohen me shtatë pikë pesë (7.5) pikë;
- 1.3. të gjitha veprimet e ndërmarra në procedurën paraprake, pas ngritjes së aktakuzës dhe draftimin e aktvendimeve mbi kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhje të aktakuzës vlerësohen me shtatë pikë pesë (7.5) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve në të cilat numri i të akuzuarve është mbi pesë (5) persona për të cilat ka përfunduar procedura me shqyrtim gjyqësor vlerësohen me njëzetë e shtatë pikë pesë (27.5) pikë;
- 1.5. pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit dhe analizimi i lëndës vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 17

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti për Krime të Rënda

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore – Departamenti për Krime të Rënda, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve, dhe pikëve të përcaktuar si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti vlerësohen me pesëmbëdhjetë (15) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve me pranim të fajësisë dhe marrëveshje për pranim të fajësisë vlerësohen me pesë (5) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve në lëndët që përfundojnë me aktvendim për hedhje të aktakuzës, si dhe lëndët e procedurës paraprake që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve, përkatësisht nxjerrjen e aktvendimeve vlerësohen me pesë (5) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve që përfshijnë vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, kontrabandimi me migrant, dhunim, vrasje, vrasje e rëndë, trafikimi me njerëz, krimi i organizuar, terrorizmi, grabitja dhe vjedhja grabitqare, si dhe të gjitha lëndët në të cilat numri i të akuzuarve është mbi pesë (5) persona për të cilat ka përfunduar procedura me shqyrtim gjyqësor, vlerësohen me njëzetë e dy pikë pesë (22.5) pikë;
- 1.5. pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit dhe analizimi i lëndës vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin

- për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 18

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti për të Mitur

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore – Departamenti për të Mitur, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve, dhe pikëve të përcaktuar si vijon:
- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij departamenti, vlerësohen me nga dy pikë shtatëdhjetë e pesë (2.75) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
 - 1.2. draftimi i vendimeve me pranim të fajësisë, marrëveshje për pranim të fajësisë dhe në procedurë të ndërmjetësimit vlerësohen me dy (2) pikë;
 - 1.3. draftimi i vendimeve për lëndët që përfundojnë me aktvendim për hedhje të aktakuzës, përkatësisht propozimit, si dhe lëndët e procedurës paraprake, përkatësisht përgatitore që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve, përkatësisht nxjerrjen e aktvendimeve, vlerësohen me një pikë pesë (1.5) pikë;
 - 1.4. draftimi i vendimeve të cilat përfshijnë vepra penale kontrabandimi me migrant, dhunim, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeçare, vrasje, vrasje e rëndë, trafikimi me njerëz, grabitja dhe vjedhja grabitqare, si dhe të gjitha lëndët në të cilat numri i të akuzuarve, përkatësisht të miturve është mbi pesë (5) persona për të cilat ka përfunduar procedura me shqyrtim gjyqësor, vlerësohen me pesëmbëdhjetë (15) pikë;
 - 1.5. pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit dhe analizimi i lëndës vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
 - 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
 - 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 19

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve, dhe pikëve të përcaktuar si vijon:
- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të divizionit penal vlerësohen me dy pikë shtatëdhjetë e pesë (2.75) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
 - 1.2. draftimi i vendimeve me pranim të fajësisë, marrëveshje për pranim të fajësisë dhe procedurë të ndërmjetësimit vlerësohen me dy (2) pikë;

- 1.3. draftimi i vendimeve për lëndët që përfundojnë me aktvendim për hedhje të aktakuzës, urdhër ndëshkimor, si dhe lëndët e procedurës paraprake që përfundojnë me ndërmarrjen e veprimeve, përkatësisht nxjerrjen e aktvendimeve, vlerësohen me një pikë shtatëdhjetë e pesë (1.75) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve që përfshijnë vepra penale lëndime të rënda trupore, vjedhje e rëndë, mashtrim, si dhe të gjitha lëndët në të cilat numri i të akuzuarve është mbi pesë (5) persona për të cilat ka përfunduar procedura me shqyrtim gjyqësor, vlerësohen me shtatë pikë pesë (7.5) pikë;
- 1.5. pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit dhe analizimi i lëndës vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 20

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve, dhe pikëve të përcaktuar si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të këtij divizioni, vlerësohen me dy pikë shtatëdhjetë e pesë (2.75) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve për pagat jubilarë, të përcjelljes në pension, shujtat dhe çështjet e tjera të kësaj kategorie, lëndët përmbartimore si dhe lëndët që përfundojnë me vendim procedural, duke përfshirë marrëveshjet e ndërmjetësimit si dhe masat e sigurimit të kërkesave, vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve në procedurën jokontestimore vlerësohen me dy (2) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve në kontestet pronësore, vërtetimi i pronësisë, servitutet, parablerja, barra sendore, e drejta e ndërtimit, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, kontestet për fyerje dhe shpifje, kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor dhe kontestet me kundërpadi me shqyrtim kryesor, vlerësohen me gjashtë (6) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarrja në shqyrtimin paraprak të padisë, analizimi i lëndës dhe pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 21

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtje

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Kundërvajtje, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve, dhe pikëve të përcaktuar si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencë të divizionit kundërvajtje vlerësohen me zero pikë shtatëdhjetë e pesë (0.75) pikë;
- 1.2. kryerja e detyrave të punës së zyrëtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.3. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 22

Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional në Gjykatën Themelore – Departamenti për Çështje Administrative

1. Norma e punës së bashkëpunëtorit profesional të Gjykatës Themelore - Departamenti për Çështje Administrative, vlerësohet sipas kategorive të lëndëve dhe pikëve të përcaktuar si vijon:

- 1.1. draftimi i vendimeve për lëndët të cilat janë në kompetencën e këtij departamenti, vlerësohen me dy pikë pesë (2.5) pikë, përveç nëse ndryshe parashihet me këtë udhëzues;
- 1.2. draftimi i vendimeve për çështjet e kthyera në rishqyrtim dhe rivendosje, si dhe lëndët për shtyrje të ekzekutimit, vlerësohen me një pikë njëzetë e pesë (1.25) pikë;
- 1.3. draftimi i vendimeve për çështjet procedurale përfshirë masat e përkohshme vlerësohen me një (1) pikë;
- 1.4. draftimi i vendimeve përfshirë anulim të kontratave administrative dhe kompensim të dëmeve të kërkuara nga këto kontrata, si dhe për leje të ndërtimit, të cilat përfundojnë me shqyrtim kryesor, vlerësohen me gjashtë (6) pikë;
- 1.5. veprimet e ndërmarra në shqyrtimin paraprak të padisë, analizimi i lëndës dhe pjesëmarrja në seancë me rastin e shqyrtimit të rastit vlerësohet me zero pikë pesë (0.5) pikë;
- 1.6. kryerja e detyrave të punës së zyrëtarit ligjor, veprimet e ndërlidhura me Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), si dhe anonimizimi i vendimeve, vlerësohen me zero pikë dy (0.2) pikë për lëndë;
- 1.7. pjesëmarrja në grupe dhe komisione të ndryshme vlerësohet me dy (2) pikë për çdo ditë të pjesëmarrjes.

Neni 23

Vlerësimin dhe raportimi për normën e punës së bashkëpunëtorit profesional

1. Vlerësimin për përmbushjen e normës mujore sipas këtij udhëzuesi në gjykata e bënë udhëheqësi i zyrës për mbështetje juridike në koordinim me gjyqtarin me të cilin punon

bashkëpunëtori profesional, ndërsa raportimin për normën e tyre në Këshillin Gjyqësor të Kosovës e bënë kryetari i gjykatës çdo tre (3) muaj.

2. Vlerësimin për përmbushjen e normës mujore sipas këtij udhëzuesi në degë të gjykatës e bënë gjyqtari me të cilin punon bashkëpunëtori profesional në koordinim me gjyqtarin mbikëqyrës, ndërsa raportimin për normën e tyre në Këshillin Gjyqësor të Kosovës e bënë kryetari i gjykatës çdo tre (3) muaj.

3. Vlerësimin për përmbushjen e normës mujore sipas këtij udhëzuesi në Gjykatën Komerciale e bënë kreu i Njesisë Ligjore në koordinim me gjyqtarin me të cilin punon bashkëpunëtori profesional, ndërsa raportimin për normën e tyre në Këshillin Gjyqësor të Kosovës e bënë kryetari i gjykatës çdo tre (3) muaj.

4. Raporti për arritjen e normës së bashkëpunëtorëve profesional shërben për vlerësimin e performancës së tyre e cila bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Zbatimi i normës në rast të pushimit vjetor dhe mjekësor të bashkëpunëtorit profesional

Pushimi vjetor është llogaritur në normën vjetore, të punës sipas këtij udhëzuesi, përkatësisht vlerësimin të normës bëhet për njëmbëdhjetë (11) muaj.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky udhëzues hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Albert Zogaj

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 06.06.2024

